



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS SË SUHAREKËS
THE MUNICIPAL OF ASSEMBLY-SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Ne bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c), lidhur me nenin 40, paragrafi 2, shkronja (h) të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008” dhe neneve 11, 15, dhe 28 paragrafi 2 pika (h) lidhur me nenin 29, pika 2 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë, 30.01.2020, miraton këtë:

V E N D I M
PËR SHPALLJE “QYTETAR NDERI” I KOMUNËS SË SUHAREKËS

Neni 1

Me këtë vendim, z. **Halil KASTRATI** i lindur me 17.04.1975 në Prizren, Përfaqësues i shoqatës bëmirëse **“Jetimat e Ballkanit”**, me seli në Prizren, shpallet **“QYTETAR NDERI”** i Komunës së Suharekës.

Neni 2

Me rastin e shpalljes qytetar nderi, Kryetari i Komunës së Suharekës, do t’i dorëzojë z. **Halil KASTARTI** medaljen **“QYTETAR NDERI”** i Komunës së Suharekës dhe do ta regjistrojë në regjistrin e bartësve të titullit **“QYTETAR NDERI”** i Komunës së Suharekës.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi, kujdeset zyra e Kryetarit të Komunës së Suharekës.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”), nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr-10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr- 016-7825
Më datë 30.01.2020





Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c), nenit 17, paragrafi 1, shkronja (b), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008” dhe nenit 3, paragrafi 2, nenit 4, nenin 9, paragrafi 1, pika 2, lidhur me 15, të udhëzimit administrativ, Nr-27/2012, të lëshuar nga MPB-ja dhe Nr-03/2012, të lëshuar nga MAPL-ja me datën 22.08.2012, neneve 15, 29, pika 2 te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës së Suharekës në mbledhjen e mbajtur me datën, 30.01.2020, miratoi këtë:

V E N D I M

Për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-020-8571, të datës 26.02.2018

Neni 1

Me këtë vendim ndryshohet-plotësohet vendimit, 01-Nr-020-8571, i datës 26.02.2018, për themelimin e këshillit komunal për siguri në bashkësi, me qëllim të zëvendësimit të anëtarëve të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, në tekstin e mëtejme (KKSB).

Neni 2

- 2.1 Pika 8, i nenit 1, të vendimit bazik ndryshohet dhe riformulohet si vijon:
Xhevahir HASANAJ.....Përfaqësues i FSK-së.....anëtar i KKSB-s
- 2.2 Pika 18, i nenit 1, të vendimit bazik ndryshohet dhe riformulohet si vijon:
Nazim SHABANAJ.....Përfaqësuese e Egjiptasve.....anëtare e KKSB-s

Neni 3

Ndërsa pjesët tjera kompletë të vendimit bazik me numër 01-Nr-020-8571, i datës 26.02.2018, mbesin të pa ndryshuara.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr-10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË SUHAREKËS

01-Nr- 016-7824
Me datë 30.01.2020



Kryesuesi i Kuvendit

Bexhet KUÇI



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL ASSEMBLY- SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c) dhe nenit 40, të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen vokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, neneve 15, lidhur me nenin 29, pika 2 te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, nenit 15 paragrafi 1, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.04/2018, për transparencën në Komuna, e në mbështetje të nenit 23, paragrafi 1, të Rregullores për transparencën në Komunën e Suharekës, 01-Nr-016-84791 të datës 27.12.2019, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën, 30.01.2020, miraton këtë:

V E N D I M

Neni 1

Me këtë vendim miratohet plani i veprimit për transparencën në Komunën e Suharekës për periudhen 2020-2023.

Neni 2.

Pjesë për bërse e këtij vendimi është plani i veprimit për transparencën në Komunën e Suharekës për periudhen 2020-2023.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit të Komunës në Suharekë.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr- 28/2008”), nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr-10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-016-7913
Me datë 30.01.2020





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS –SUHAREKË
MUNICIPAL ASSEMBLY-SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, publikuar në “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, e në mbështetje të dispozitave të Rregullores (QRK) Nr. 13/2017 për riintegrimin e personave të riatdhesuar, e konform neneve 15, lidhur me nenin 29, pika 2 te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën, 30.01.2020, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Me këtë vendim miratohet Plani Komunal për Ri-integrimin e Qëndrueshëm te Personave të Riatdhesuar në Komunë Suharekës për periudhen 2020-2022.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani Komunal për Ri-integrimin e Qëndrueshëm te Personave të Riatdhesuar në Komunë Suharekës për periudhen 2020-2022.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Suharekës, konkretisht Zyra Komonale për Komunitete dhe Kthim.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr-10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË



Kryesuesi i Kuvendit

Bexhet KUÇI

01-Nr- 016-7909
Me datë 30.01.2020



Ne baze te neneve 12, 17 lidhur me nenin 28 dhe 29, të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, e në mbështetje të nenit 6, pika 2.1 lidhur me pikën 6, të Ligjit Nr-04/L-010 për bashkëpunim ndër-komunal, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-7/2011” dhe konform nenit 5, paragrafi 1, pika 1.1 lidhur me nenin 6, të Rregullores Nr. 09/2013 për nxitjen e bashkëpunimit ndër-komunal dhe neneve 15, 29, pika 2 te Statutit të Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, , Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën, 30.01.2020, miraton këtë:

V E N D I M

Neni 1

- 1.1 Miratohet nisma e Kryetarit të Komunës së Suharekës për të hyrë në bashkëpunim ndër-komunal me Komunat tjera të Republikës së Kosovës.
- 1.2 Bashkëpunimi ndër-komunal do të zhvillohet në mesë të Komunave tjera të Republikës së Kosovës si në vijim:
 - 1.2.1 Komunës së Suharekës të Republikës së Kosovës
 - 1.2.2 Komunës së Prizrenit të Republikës së Kosovës
 - 1.2.3 Komunës së Dragashit të Republikës së Kosovës dhe
 - 1.2.4 Komunës së Mamushes të Republikës së Kosovës

Neni 2

AUTORIZOHET, Kryetari i Komunës që të fillon konsultimet dhe bisedimet për hartimin e marrëveshjes për bashkëpunim ndër-komunal në mesë të Komunës së Suharekës të Republikës së Kosovës, Komunës së Prizrenit të Republikës së Kosovës, Komunës së Dragashit të Republikës së Kosovës dhe Komunës së Mamushesë të Republikës së Kosovës dhe palët tjera të interesuare për bashkëpunim.

Neni 3

OBLIGOHET- Kryetari i Komunës që pas përfundimit të konsultimeve dhe në bazë të konsultimeve paraprake të përgatisin draft-marrëveshjen për themelimin e bashkëpunimit ndër-komunal në mesë 4, (katër) Komunave dhe atë në kuadër të kompetencave të tyre vetanake, financimin e “Qendrës për strehimin e grave dhe fëmijëve” dhe nënshkruhet nga Kryetaret e Komunave dhe miratohet nga Kuvendet Komunale të Komunave që janë pjesëmarrse në bashkëpunimin ndër-komunal.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”), nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr-10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr- 016-7828

Më datë 30.01.2020



Kryesuesi i Kuvendit

Bexhet KUÇI